



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2148/6 prot.

Tiranë, më 11.12.2025

VENDIM

Nr. 42, datë 11.12.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës me nr. 2148 prot., datë 27.08.2025, vijuar nëpërmjet nëpërmjet e-mail-it të datës 13.10.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2148/3 prot., datë 13.10.2025 dhe e-mail-it datë 07.11.2025, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2148/4 prot., datë 10.11.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Universiteti Politeknik i Tiranës (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës për informacion, të depozituar pranë Autoritetit Publik me nr. 2198 prot., datë 08.08.2025, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni i mëposhtëm:

1. *Të më vihet në dispozicion informacion mbi procedurat e ndjekura deri më tani nga Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me këtë projekt;*
2. *Të më vihet në dispozicion kopje e plotë e dokumentacionit që universiteti ka hartuar ose disponon lidhur me këtë projekt;*
3. *Kopje e gjithë korrespondencës zyrtare të zhvilluar me institucionet e tjera publike ose private në lidhje me këtë projekt;*
4. *Kopje të plotë të projektit teknik (planimetria, studimet, relacionet shoqëruese, etj.), në format elektronik ose fizik;*

5. *Informacion nëse inxhinierët dhe topografët e përfshirë në projekt kanë qënë fizikisht në pronën time për të kryer matje, dhe nëse po, kërkoj të më jepet data dhe ora e saktë sipas procesverbalit të mbajtur;*
6. *Kopje të të gjitha akteve dhe raporteve teknike të hartuara nga Universiteti Politeknik për këtë projekt.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 2198/1 prot., datë 21.08.2025, i ka kthyer përgjigje Ankuesit, duke cituar se: “...në këtë marrëdhënie juridike UPT është angazhuar në cilësinë e kontraktorit i cili është i detyruar të respektoj me korrektësi detyrimet kontraktuale, ku ndër të tjera përfshihen dhe dispozitat për informacionin konfidencial dhe pronësinë intelektuale...”.

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji, konkretisht, urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 08.08.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në këto kushte, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2148/1 prot., datë 28.08.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën objekt shqyrtimi.

Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje Komisionerit nëpërmjet shkresës nr. 2268/2 prot., datë 04.09.2025, në të cilën shprehet se: “...Me shkresën nr. 2198/1 prot., datë 21.08.2025, kërkuesi është sqaruar se në marrëdhënien juridike që UPT ka me ARRSH, në cilësinë e kontraktuesit, UPT është i detyruar të respektoj detyrimet kontraktuale, ku ndër të tjera përfshihen dhe dispozitat për “informacionin konfidencial dhe prona intelektuale”...”

Ankuesi ka vijuar ankimin e tij nëpërmjet e-mail-it të datës 13.10.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2148/3 prot., datë 13.10.2025 dhe e-mail-it datë 07.11.2025, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2148/4 prot., datë 10.11.2025.

Në ndjekje të procedurave për shqyrtimin administrativ të çështjeve, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nëpërmjet shkresës nr. 2148/5 prot., datë 10.11.2025, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me

prezencën e Ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, Ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën e paraqitur. Përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në shkresat nr. 2198/1 prot., datë 21.08.2025 dhe nr. 2268/2 prot., datë 04.09.2025, duke paraqitur një kopje të kontratës së shërbimit lidhur midist Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar, në mbështetje të argumentave të paraqitura.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të objektit të ankimit si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Pika 2 dhe 3 të nenit 14 të LDI përcaktojnë se: *“2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit: a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet. 3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.”*

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Universiteti Politeknik i Tiranës është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI, por vetëm duke u bazuar në marrëdhënien kontraktuale midis dy palëve. Në çdo rast, duke qenë se të dyja palët në kontratë konsiderohen Autoritete Publike sipas LDI, argumentat e paraqitura se *“...të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontaktuesi gjatë kontratës do i përkasin porositësit i cili mund t'i përdori ato sipas gjykimit të tij...”*, nuk qëndron pasi si Autoriteti Rrugor Shqiptar si Universiteti Politeknik

i Tiranës, në rolin e Autoriteteve Publike të financuara nga buxheti i shtetit, kanë përdorur fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për financimin dhe realizimin e dokumentacionit të kërkuar, në zbatim të projektit infrastrukturor.

Vlen të theksohet se informacioni/dokumentacioni i kërkuar lidhet me një investim të rëndësishëm në infrastrukturë, i cili prek drejtpërsëdrejti qytetarët dhe interesi publik për të aksesuar informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe tejet i lartë.

Për sa më sipër parashtruar, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2 të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar, sipas të cilës: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, deklarimit dhe parashtrimeve të depozituara nga Autoriteti Publik, Komisioneri konstaton se, znj. Nertila Hodo, me detyrë Specialiste e Komunikimit dhe Shërbimeve dhe znj. Donika Qafa, me detyrën e koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, kanë refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në kundërshtim me parashikimet e LDI.

Në këto kushte, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të LDI, *refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë*.

Bazuar në pikën 4 të nenit 19, të LDI, *çdo person përgjegjës, i cili me veprimet dhe mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji, ka përgjegjësi administrative për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 2, të nenit 18 të këtij ligji*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e

krijua, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 2148 prot., datë 27.08.2025, ndaj Autoritetit Publik, Universiteti Politeknik i Tiranës me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 11.08.2025, konkretisht: “1. Të më vihet në dispozicion informacion mbi procedurat e ndjekura deri më tani nga Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me këtë projekt; 2. Të më vihet në dispozicion kopje e plotë e dokumentacionit që universiteti ka hartuar ose disponon lidhur me këtë projekt; 3. Kopje e gjithë korrespondencës zyrtare të zhvilluar me institucionet e tjera publike ose private në lidhje me këtë projekt; 4. Kopje të plotë të projektit teknik (planimetria, studimet, relacionet shoqëruese, etj.), në format elektronik ose fizik; 5. Informacion nëse inxhinierët dhe topografët e përfshirë në projekt lanmë qënë fizikisht në pronën time për të kryer matje, dhe nëse po, kërkoj të më jepet data dhe ora e saktë sipas procesverbalit të mbajtur; 6. Kopje të të gjitha akteve dhe raporteve teknike të hartuara nga Universiteti Politeknik për këtë projekt.”, brenda datës 18.12.2025;
3. Dënimin e znj. Donika Qafa, në cilësinë e koordinatorit për të Drejtën e Informimit, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar;
4. Dënimin e znj. Nertila Hodo, në cilësinë e Specialistes e Komunikimit dhe Shërbimeve, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e

- Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar;
5. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
 6. Kundër vendimmarrjes në pikat 3 dhe 4, personat ndaj të cilëve është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
 7. Ky vendim u shpall sot në datë 11.12.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi